

D. H. Beshiri
22.10.19



RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9831,DATE 12.11.2007, ”PËR DËMSHPËRBLIMIN E ISH TË DËNUARVE POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”,TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i projektligjit “ Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9831,datë 12.11.2007,”Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”,të ndryshuar “, është mbështetur në nenet 78,81,pika 1,dhe 82,të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë .

Ky projectligj ka për qëllim:

- Të përputhë ligjin e dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist Nr. 9831,datë 12.11.2007 me ligjin Nr.7748,dt.29.07.1993, që përcakton statusin e ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë.
- Të mos prekë dëmshpërblimet bazike të mbijetesës,që ka përfituar ish i dënuari dhe ish i përndjekuri politik nga ligje të tjera të mëparshme
- Familjarët e viktimave,të pushkatuar pa gjyq, të pushkatuar apo ekzekutuar me dënim politik të padrejtë, të perfitojnë dëmshperblimin financiar në masën e 25 viteve kompesim dënimi me burgim,me dënimin maksimal mbas faljes së jetës.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË ,PROBLEMATIKAT,EFEKTET E PRITSHME

Dëmshpërblimi i ish të përndjekurve është një detyrim moral i shoqërisë Shqiptare.Sakrificat e tyre janë në themel të sistemit kapitalist që sot shoqëria jonë aplikon.Dëmshperblimi i tyre duhet të jetë në përpjestim të drejtë me sakrificat dhe vuajtjet e tyre.

Përputhja e ligjit të dëmshpërblimit me ligjin e statusit të ish të përndjekurit politik,shbën diskriminimin pasiv që krijonte ligji i dëmshpërblimit të ish të përndjekurve politikë ,brenda të njëjtës kategori sakrifice “kategorisë së humbjes së jetës”,për të njëjtin shkak dhe nga i njëjti mekanizëm politik ,Partia komuniste.

Kur shkaku i humbjes së jetës është i njëjtë “kundërshtia e komunizmit”, afatet nuk kanë vlerë,ato nuk mund të ndryshojnë thelbin e çështjes,duke shpërfillur humbjet e jetëve njerëzore.

Dëmshpërblimet e përfituara nga ligje të tjera,si banesa me të meta të theksuara , jashtë standarteve funksionale dhe letra me vlerë që nuk janë përdorur , janë të papërfillshme,sepse nuk i kanë dhënë efekte sociale shoqërisë,prandaj duhen neglizhuar.

Nga ana tjetër pagesa e dëmshpërblimit sot është në nivele të ulëta në krahasim me atë që sot japin gjykatat dëmshpërblim për një ditë burgu,duke mos harruar që cilësia e burgjeve sot ndryshon shumë nga ai ku ata kanë vuajtur dënimin e padrejtë.

Që ligji të ketë një balancë logjike të qëndrueshme nuk mund të pranohet ekujvalenca e humbjes së jetës së njeriut me 8(tetë) vite burg dëmshpërblim,kur dënimi mbas faljes së jetës ka qenë dhe është 25 vjet burg.Kështu që referencë të dëmshpërblimit për humbjen e jetës duhet sjellë të pakten në nivelin e 25 viteve të dënimit me burg.

Ky projektakt do të sjelli efekte pozitive tek qytetarët për emancipimin e mendimit politik në raport me vazhdimësinë e së djeshmes.Njëkohësisht do të kemi një tendencë positive në drejtim të paqes midis shtresave shoqërore me bindje politike të ndryshme të krijuara në mënyrë artificiale nga “lufta e klasave” e regjimit të kaluar.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË,KUSTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMËETAR

Projektligji është përgatitur në mbështetje të neneve 78,81,pika 1,dhe 82,të Kushtetutës,si dhe në nenin 68 të rregullores së Kuvendit.


**IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME AQUIS TË
BASHKIMIT EUROPIAN (PËR PROJEKTAKTET
NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon të bëjë përafrim me aquis e Bashkimit European.

**V. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE
SHPENZIMETVE BUXHETORE**

Efekti i këtij projektakti në buxhetin e shtetit do të jetë pjesë e integruar e masës së dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë, por do të rrisi kohën e shlyerjes, e cila do të jetë pjesë e buxhetit në mënyrë periodike çdo vit derisa të përfundojë totalisht.

DEPUTETI



ARTUR ROSHI